



UNMIK/REG/2005/46  
14 tetor 2005

---

**RREGULLORE NR. 2005/46  
PËR SHPALLJEN E LIGJIT MBI SHËRBIMET SOCIALE DHE FAMILJARE  
TË MIRATUAR NGA KUVENDI I KOSOVËS**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Në pajtim me nenet 9.1.44 dhe 9.1.45 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9),

Duke marrë parasysh shkresën zyrtare nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës të datës 15 maj 2005 lidhur me Ligjin mbi shërbimet sociale dhe familjare nr. 02/L-17 të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 21 prill 2005,

Me anë të kësaj shpall Ligjin mbi shërbimet sociale dhe familjare (Ligji nr. 02/L-17) të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, që i bashkëngjitet kësaj Rregulloreje, i cili bëhet i plotfuqishëm në datën e nënshkrimit, me kusht që:

- (a) Fjala “rregullore” në nenet 3.3 (a), 5.5, 5.21 dhe 15.11 të zëvendësohet me “udhëzime administrative”;
- (b) Fjalja e dytë në nenin 10.6 të ndryshohet në: “Pamundësia e grupeve të cekura më lart për të vepruar asisoji mund të sanksionohet sipas ligjit në fuqi”;
- (c) Neni 11.22 ndryshohet si vijon: “Çdo person apo persona që planifikojnë adoptim jashtë dispozitave të këtij Ligji apo që tentojnë që këtë t’ a bëjnë mund të sanksionohen sipas ligjit në fuqi”;
- (d) Në nenin 11.23 dhe 15.2 të ndryshohen fjalët pas fjalisë “do të jenë fajtorë për shkelje të rënda profesionale” dhe të zëvendësohen me “dhe mund të sanksionohen sipas ligjit në fuqi”.

Këto ndryshime do të paraqiten në tekstin përfundimtar zyrtar të Ligjit.

Nënshkruar sot, më 14 tetor 2005.

Søren Jessen - Petersen  
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm